VENDIM
Nr. 47, datë 31.1.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 786, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE RUAJTJEN E VARREZAVE TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e dëshmorit të atdheut", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 786, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë institucione përgjegjëse për projektimin dhe ndërtimin e Varrezave të reja të Dëshmorëve të Atdheut dhe rikonstruksionin e tyre. Projektimi, ndërtimi dhe rikonstruksioni bëhen kundrejt fondeve buxhetore që do të akordohen, rast pas rasti.".

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama